



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE**

Nr. 3321 prot.

Vau Dejës, më 08/06 / 2022

**Lënda:** Dërgohet material për shqyrtim e miratim **Z. Mark Bisha**

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS**

**I nderuar zoti Kryetar,**

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për miratim Projekt Vendimin nr.2 dt.06.06.2022  
“Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e shërbimit vullnetar të Bashkisë  
Vau-Dejës”

**KRYETARI**  
**Mark BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV/ KRYETARI**  
**Lestinë NDOJA**



**Konceptoi: Valjeta Nikaj**, Përgjegjëse e Sektorit të Emergjencave Civile

Datë: \_\_\_\_\_

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: \_\_\_\_\_

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES  
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE**

**PROJEKT V E N D I M**  
Nr. 02, datë 06.06.2022

**PËR  
KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT VULLNETAR  
TË BASHKISË VAU DEJËS**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të nenit 9 dhe 10, të ligjit nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 506, datë 17.7.2019, “Për miratimin e kodit të etikës së vullnetarit”, të Urdhrit nr. 299, datë 6.11.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për formën dhe përmbajtjen e librezës së vullnetarizmit”, të Urdhrit nr. 300, datë 6.11.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për formën dhe përmbajtjen e regjistrit të kontratave të vullnetarizmit”, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Vau Dejës,

**V E N D O S I:**


1. Në cilësinë e ofruesit dhe përfituesit të vullnetarizmit, pranë Bashkisë Vau Dejës, të krijohet “Shërbimi Vullnetar i Bashkisë Vau Dejës”.
2. Shërbimi Vullnetar i Bashkisë Vau Dejës organizohet pranë **Sektorit të Emergjencave Civile**, dhe ofron vullnetarizëm në fushat si më poshtë:
  - a) Mbrojtja e mjedisit.
  - b) Mbrojtja dhe përkujdesja sociale.
  - c) Vëzhgimin, sinjalizimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje.
  - d) Kulturës dhe sportit.
3. Sektori/drejtorja e **Emergjencave Civile**, përgjigjet për:
  - a) Regjistrimin e vullnetarëve.
  - b) Regjistrimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë apo kërkojnë të ofrojnë vullnetarizëm brenda territorit administrativ të bashkisë Bashkisë Vau Dejës.
  - c) Organizimin e vullnetarëve në “Skuadra vullnetare”, me përbërje 10-15 anëtare, sipas fushës së vullnetarizmit që do të ofrohet.
  - d) Përgatitjen e planit të aktiviteteve të Shërbimit Vullnetar të Bashkisë Vau Dejës.
  - e) Bashkërendimin e veprimtarisë me drejtoritë e bashkisë për identifikimin e nevojave për vullnetarizëm dhe kryerjen e aktiviteteve të vullnetarizmit.
  - f) Bashkërendimin e veprimtarisë me “Skuadrat vullnetare” dhe organizatat jofitimprurëse të regjistruara, për ofrimin e vullnetarizmit;
  - g) Monitorimin dhe vlerësimin e shërbimit vullnetar;
  - h) Organizimin e trajnimit të vullnetarëve;



- i) Pajisjen me uniformë, vegla e pajisje të domosdoshme pune sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e vullnetarizmit;
  - j) Përgatitjen e projekt-raportit vjetor mbi gjendjen e vullnetarizmit në Bashkinë Vau Dejës.
4. Vullnetar i Shërbimit Vullnetar të Bashkisë Vau Dejës, mund të bëhet:
- a) Çdo person, vendas ose i huaj, që gëzon zotësi të plotë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi dhe me vullnet të lirë kryen vullnetarizëm.
  - b) Çdo person me aftësi të kufizuara, i cili mund të kryejë vullnetarizëm, në përputhje me aftësitë dhe zhvillimin e tij fizik e mendor.
  - c) Çdo i mitur i moshës 15 deri 18 vjeç, kur prindi ose përfaqësuesi i tij ligjor ka dhënë pëlqimin me shkrim për lidhjen e kontratës.
5. Të drejtat dhe detyrimet e vullnetarëve të Shërbimit Vullnetar të Bashkisë Vau Dejës janë ato të përcaktuara në ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi për vullnetarizmin, si dhe të drejta e detyrime të tjera të përcaktuara në kontratën e vullnetarizmit, për aq sa ato nuk çenojnë të drejtat e përcaktuara në ligj.
6. Për tu regjistruar si vullnetar i Shërbimit Vullnetar të Bashkisë Vau Dejës, çdo person duhet të paraqes pranë bashkisë këto dokumente:
- a) Kërkesë me shkrim ku të përcaktohet fusha e vullnetarizmit që dëshiron të ofrojë.
  - b) Fotokopje të kartës së identitetit ose pasaportës.
  - c) Jetëshkrimin.
  - d) Vërtetim të gjendjes shëndetësore.
  - e) Çdo dokument tjetër që dëshmon aftësitë në kuadër të angazhimit të tij si vullnetar.
7. Organizatat jofitimprurëse të cilat dëshirojnë të ofrojnë vullnetarizëm në territorin administrativ të Bashkisë Vau Dejës, duhet të deklarojnë objektin dhe qëllimin e vullnetarizmit dhe të dorëzojnë për regjistrim, dokumentet si më poshtë:
- a) Kërkesën për ofrim vullnetarizmi ose njoftimin për ofrim të vullnetarizmit për rastet kur organizata është e autorizuar të kryej vullnetarizëm nga institucioni i prefektit, një institucion qendror ose ministri e linjës.
  - b) Dokumentin ligjor të regjistrimit si organizatë jofitimprurëse.
  - c) Ekstraktin historik të lëshuar nga organi publik kompetent.
  - d) Projektin ose planin për kryerjen e vullnetarizmit, si dhe përshkrimin e rezultateve që priten të arien.
8. Sektori/ drejtorja i **Emergjencave Civile** pasi verifikon saktësinë e dokumentacionit të dorëzuar dhe përmbushjen e kriterëve ligjore të kërkuesit për vullnetarizëm:
- a) Përgatit kontratën e vullnetarizmit sipas "Aneksi A" bashkëlidhur këtij vendimi, e cila nënshkruhet nga kryetari i Bashkisë/ nënkryetari/ ose drejtorja (*këshillohet që kontrata e vullnetarizmit të nënshkruhet nga kryetari ose nënkryetari i Bashkisë pasi simbolika është me e fortë, por mund të caktohet dhe drejtori i drejtorisë përgjegjëse për shërbimin vullnetar*).
  - b) Kryen regjistrimin e personit si vullnetar të Shërbimit Vullnetar të Bashkisë Vau Dejës.

- c) Kryen regjistrimin e organizatës jofitimprurëse si ofrues vullnetarizmi në Bashkinë Vau Dejës.
  - d) Lëshon vërtetimin për regjistrimin e personit si vullnetar të Shërbimit Vullnetar të Bashkisë Vau Dejës.
  - e) Lëshon vërtetimin për regjistrimin e organizatës jofitimprurëse si ofrues vullnetarizmi në Bashkinë Vau Dejës.
9. Shërbimi Vullnetar i Bashkisë Vau Dejës aktivizohet dhe drejtohet nga **sektori i emergjencave civile**
10. Për numrin, përbërjen dhe fushën e veprimtarisë së Shërbimit Vullnetar të Bashkisë Vau Dejës, të informohet çdo vit institucioni i Prefektit, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, dhe ministria përgjegjëse për çështjet e punës,
11. Përgjigjet për zbatimin e këtij vendimi: drejtoritë në bashkinë Vau Dejës, vullnetarët e Shërbimit Vullnetar të Bashkisë Vau Dejës, dhe organizatat jofitimprurëse që ofrojnë vullnetarizëm në territorin administrativ të bashkisë.

*Konceptoj: Valjeta Nikaj*  
*Konceptoi Bazën Ligjore Kristinë Shtatri*



**KRYETARI**  
Mark **BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**ZV/ KRYETARI**

Lestinë **NDOJA**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES  
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Vau Dejës, me \_\_\_\_ / \_\_\_\_ 2022

**RELACION**

**PËR MIRATIMIN E  
KRIJIMIT, ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË SHËRBIMIT VULLNETAR  
TË BASHKISË VAU DEJËS**

**Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës**

**Të nderuar këshilltarë,**

Bashkia Vau Dejës ka një territor të gjerë, ku në lidhje me emergjencat civile jemi shumë të riskuar. Kjo, nisur edhe nga përvojat e viteve të kaluara ku ne si bashki jemi përballur me rënien e zjarreve në pyje e kullota, toka bujqësore, banesa e subjekte private dhe njëkohësisht jemi përballur dhe me përmbytjet në zonën e Bushatit, si dhe probleme të tjera të rrëshqitjeve në zona të tjera të Bashkisë.

Nisur nga kjo, për marrjen e masave paraprake dhe në shërbim të emergjencave civile në bashkinë tonë, është e nevojshme ngritja e skuadrave vullnetare, të cilat do të funksionojnë në rastet ku do të ketë emergjencë civile.

Bazuar në Reformën Territoriale, miratuar me Ligjin nr 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Bushat, Hajmel, Vig Mnelë, Vau-Dejës, Temal dhe Shllak. Bashkia ka nën administrim 47 fshatra dhe një qytet. Njësia administrative Bushat ka numrin më të lartë të fshatrave (14 fshatra), i cili vijohet nga Temal (10 fshatra). Njësitë administrative Vig Mnelë dhe Hajmel kanë një numër shumë të vogël të fshatrave, respektivisht tre dhe pesë. Të gjitha njësitë janë pjesë e rrethit Shkodër të Qarkut Shkodër.

**Në Ligjin nr 45/2019 “Për mbrojtjen civile”**, Neni 11, thuhet: Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë “Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore, me vendim të këshillit bashkiak, miraton, minimalisht çdo pesë vjet, strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, të harmonizuar me Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë”.

**Ngritja dhe organizimi i shërbimit vullnetar në bashki**

Kuadri ligjor:

1. Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”,
2. VKM nr. 667, datë 10.11.2021 “Për trajtimin e vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile, apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive”,

3. Ligji nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin”.
4. VKM nr. 506, datë 17.7.2019, “Për miratimin e kodit të etikës së vullnetarit”.
5. Urdhër nr. 299, datë 6.11.2018, i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për formën dhe përmbajtjen e librezës së vullnetarizmit”.
6. Urdhër nr. 300, datë 6.11.2018, i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për formën dhe përmbajtjen e regjistrit të kontratave të vullnetarizmit”.

Neni 38, ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, i kushton një rëndësi të veçantë rolit të shërbimit vullnetar të mbrojtjes civile, duke e përcaktuar atë si një nga strukturat operationale të sistemit të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë.

**Qëllimi i ngritjes së shërbimit vullnetar:** Të rris angazhimin dhe pjesëmarrjen e individëve në jetën sociale për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet, si dhe të zhvilloj vlerat e solidaritetit njerëzor.

#### **Ofruesi i vullnetarizmit**

- Çdo person, vendas ose i huaj, që gëzon zotësi të plotë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi dhe me vullnet të lirë kryen vullnetarizëm;
- Çdo person me aftësi të kufizuara, i cili mund të kryejë vullnetarizëm, në përputhje me aftësitë dhe zhvillimin e tij fizik e mendor;
- Çdo i mitur i moshës 15 deri 18 vjeç, sipas përcaktimeve të ligjit.

#### **Përfituesi i vullnetarizmit**


- Përfituesi i vullnetarizmit mund të jetë një person fizik ose juridik, vendas ose i huaj
- Përfituesi i vullnetarizmit mund të jetë në të njëjtën kohë edhe ofrues i vullnetarizmit.

#### **Kohëzgjatja e vullnetarizmit**

- Kohëzgjatja ditore e vullnetarizmit është jo më shumë se 5 orë në ditë.
- Kohëzgjatja javore e vullnetarizmit është jo më shumë se 25 orë në javë

Për aq kohë sa kuadri ligjor dhe nënligjor për organizimin dhe funksionimin e shërbimit vullnetar të mbrojtjes civile nuk është plotësuar ende, ne do organizojmë vetëm “shërbimin vullnetar” në përputhje me parimet dhe kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin”. Angazhimi jonë në krijimin dhe organizimin e “shërbimit vullnetar” është një hap shumë i rëndësishëm për krijimin në të ardhmen të “shërbimit vullnetar për mbrojtjen civile”, pasi ky angazhim do t’u mundësojë atyre krijimin e përvojës së nevojshme dhe rritjen e aftësive për të ngritur, organizuar dhe menaxhuar me efektivitet “shërbimin vullnetar të mbrojtjes civile”.

**Konceptoi: Valjeta Nikaj**



**KRYETARI**

**Mark BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**ZV/ KRYETARI**

Lestinë **NDOJA**

